

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-074/15

**Prishtinë,
2 Nëntor 2016**

Në çështjen juridike të:

R. S.-S.

Pala ankuese

kundër

N/A

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA38602), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 Nëntor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e R. S-S e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 të datës 13 mars 2014 sa i përket kërkesës së regjistruar me numër KPA38602, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 i datës 13 mars 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar me numër KPA38602, vërtetohet.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 6 qershor 2007, R. S-S (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP-së) duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore mbi ngastrën kadastrale me numër 95/1 me kulturë, arë e kultivuar me sipërfaqe prej 03.40.00 ha e cila gjendet në vendin e quajtur “Maliste-Stojanova”, fshati “Gusicë” në komunën e Vitisë (tani e tutje: prona e kërkuar).
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo i ka dorëzuar AKP-së dokumentet në vijim:
 - Procesverbalin nr. 166/97 lidhur me marrëveshjen gjyqësore, të lëshuar nga Gjykata Komonale e Vitisë më 26 qershor 1997. Në bazë të procesverbalit, ndërmarrja “AgroMorava” në cilësi të debitorit është obliguar që t’ia njohë të drejtën pronësore dhe t’ia dorëzojë pronën e kërkuar në posedim R.S-S. në cilësi të kreditorit.
 - Përshkrimin e fletës poseduese nr. 2/94 të lëshuar nga Administrata e Gjeodezisë e Komunës së Vitisë më 30 prill 1998, në të cilën pala ankuese figuron si pronare e pronës së kërkuar.
3. Më 17 qershor 2008, AKP-ja ka bërë njoftimi ne pronës së kërkuar duke e publikuar kërkesën në Gazetën e Njoftimit të AKP-së Nr. 2 të qershorit 2010 dhe në Buletinin e Zyrës për Pronë të UNHCR-së. Gazeta dhe lista i janë lënë komunës së Vitisë e cila ka pranuar që t’i vë në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet e njëjta janë lënë në hyrje dhe dalje të fshatit Gërmovë, Zyra Kadastrale e Komunës së Vitisë dhe Gjykatën Komonale të Vitisë. Saktësia e njoftimit është konfirmuar në të njëjtë datë.

Asnjë palë e interesuar nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesë brenda afatit prej 30 ditësh, prandaj kërkesa është konsideruar jokontestuese.
4. Procesverballi Nr. 166/97 është verifikuar negativisht nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së edhe në Gjykatën Komonale të Vitisë edhe tek institucionet e zhvendosura të Republikës së Serbisë, ndërsa Departamenti i Kadastrit i Komunës së Vitisë ka konfirmuar se ngastra kadastrale nr. 95 është e plotë, e pandarë dhe e regjistruar si pronë shoqërore “Zemljoradnica Zadruga” (Koopërativa Bujqësore). Sekretariat Ekzekutiv i AKP-së ka bërë përpjekje që sipas detyrës zyrtare të verifikojë aktgjykimin Nr. 112/96, të datës 06 shkurt 1997 të lëshuar nga Gjykata Komonale e Vitisë që ka qenë baza juridike për ta fituar të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar, mirëpo rezultati i verifikimit ka qenë negativ.
5. Nga provat në shkresat e lëndës vërehet se pala ankuese është kontaktuar nga AKP-ja përmes telefonit dhe ajo ka konfirmuar se ka humbur posedimi mbi pronën e kërkuar më 1954 (faqe 054 e shkresave të lëndës).
6. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës përmes vendimit të tij KPCC/D/A/228/2014 të datës 13 mars 2014, ka vendosur ta hedhë poshtë kërkesën pasi që bie jashtë kompetencave të KKKP-së për arsye se paraqitësi i kërkesës nuk ka treguar se kërkesa e saj përfshinë rrethana që lidhen drejtpërdrejt ose rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999.
7. Vendimi i KKKP-së iu dorëzua palës ankuese më 27 tetor 2014. Ajo ka paraqitur ankesë më 17 nëntor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese pretendon se KKKPK-ja ka vërtetuar faktet materiale në mënyrë jo të plotë dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material.
9. Pala ankuese pretendon se konstatimi i KKKPK-së, se në bazë të deklaratës së palës ankuese humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar ka ndodhur më 1954 nuk është i vërtetë. Ajo ka deklaruar se asnjëherë nuk i ka dhënë askujt asnjë deklaratë apo nuk ka dorëzuar ndonjë dokument në lidhje me çështjen e përmendur në vendimin e KKKPK-së. Pala ankuese ka kërkuar që t'i sigurohet dokumenti në të cilin ajo ka deklaruar një gjë të tillë, nëse ky dokument ekziston.
10. Në ankesë, pala ankuese ka paraqitur në detaje dokumentet të cilat i ka dorëzuar për ta vërtetuar të drejtën e saj pronësore dhe nga Gjykata Supreme ka kërkuar që të marrë një vendim të ri me anë të së cilit do t'ia vërtetonte të drejtën pronësore.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

11. Gjykata Supreme ka shqyrtuar vendimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi procedurën kontestimore Nr. 03/L-006 (tani e tutje: LPK), dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se:
Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-079, i cili përcakton se pala mund të paraqes ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit të palëve lidhur me vendimin.

Meritat e ankesës

12. Gjykata Supreme ka shqyrtuar ankesën në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
13. KKKPK-ja ka bazuar vendimin e tij në faktin se paraqitësja e kërkesës nuk ka treguar se si kërkesa e saj përfshin rrethanat që lidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999.
14. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhrin e Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, por gjithashtu që ai apo ajo nuk është në gjendje t'i ushtrojë të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
15. Gjatë dorëzimit të kërkesës pranë AKP-së, më 6 qershor 2007, pala ankuese ka deklaruar datën 12 qershor 1999 si datë të humbjes së posedimit të pronës së kërkuar.
16. Nga provat në shkresat e lëndës mund të shihet se ajo gjoja është kontaktuar përmes telefonit nga zyrtari i AKP-së dhe sipas shënimeve në shkresat e lëndës ajo ka konfirmuar se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar ka ndodhur në vitin 1954, mirëpo në fazën e apelit ky pretendim është mohuar nga pala ankuese.
17. Neni 99 paragrafi 1 i LPK-së përcakton se kërkesa, përgjigja në kërkesë, ankesat dhe deklaratat e tjera, propozimet dhe njoftimet, që bëhen jashtë seancave gjyqësore, paraqiten me shkrim (parashtrës).

18. Në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë e cila vërteton se pala ankuese ka dorëzuar një deklaratë me shkrim me të cilën ka deklaruar se humbja e posedimit ka ndodhur më 1954. **Biseda telefonike nuk është provë e mjaftueshme për vërtetimin e faktit.**
19. Megjithatë, çështja që duhet shqyrtuar në këtë lëndë është nëse pala ankuese ka paraqitur prova për të vërtetuar të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar; prandaj, Gjykata Supreme do ta paraqes një përmbledhje të shkurtër përkitazi me këtë çështje.
20. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka verifikuar negativisht dokumentet mbi të cilat pala ankuese ka bazuar kërkesën pronësore. KKPK-ja sipas detyrës zyrtare nuk ka mundur të sigurojë ndonjë provë në mbështetje të kërkesës së palës ankuese.
21. Procesverbali nr. 166/97 lidhur me marrëveshjen gjyqësore, i lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë më 26 qershor 1997, nuk është gjetur në institucionet kompetente në Kosovë dhe Serbi. Madje, edhe baza ligjore përmes të cilës pala ankuese gjoja e ka fituar të drejtën pronësore, aktgjykimi nr. 112/96, i datës 06 shkurt 1997 i lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë nuk është gjetur pranë institucionit kompetent.
22. Sipas nenit 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980), në fuqi në kohën kur është lëshuar aktgjykimi, e drejta pronësore mund të fitohet nga vetë ligji, në bazë të marrëdhënies juridike ose trashëgimisë ... në bazë të marrëdhënies juridike (që në këtë rast është aktgjykimi) e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin "regjistrin kadastral", ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme të përcaktuar me ligj me nenin 33 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980).
23. Në certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme prona figuron e plotë me numër 95 dhe jo e ndarë në ngastrën kadastrale 95/1, për më tepër prona është regjistruar si pronë shoqërore "Zemljoradnica Zadruga" (Kooperativa bujqësore), që do të thotë se aktgjykimi i përmendur në paragrafin 23 të këtij aktgjykimi nuk është ekzekutuar asnjëherë. Sipas të gjeturave, pala ankuese nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që kushtet nga neni 33 i Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore (RSFJ, Nr. 6/1980) nuk janë përmbushur.
24. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja në vend se ta hedhtë poshtë kërkesën e palës ankuese për shkak se bie jashtë juridiksionit do të duhej ta refuzonte atë në mungesë të provave për vërtetimin e së drejtës pronësore.
25. Pasi që vetëm pala ankuese ka paraqitur ankesë dhe gjykata nuk mund t'ia përkeqësoj gjendjen palës ankuese në krahasim me vendimin e kontestuar (*reformatio in pejus*), vendimi i KKPK-së duhet të vërtetohet.
26. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3 (a) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it